

**NË EMER TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE Departamenti i përgjithshëm**, me Gjyqtarin Gezim Ademi, procesmbajtëse Hasnije Muhaxheri, duke vendosur në lëndën penale ndaj të pandehurit S.J, nga ... për shkak të veprës penale **Lëndim i rend trupor nga neni 189 par.1 nën par 1.3 te KPRK-ës** ,duke vendosur lidhur me Aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Mitrovice Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.1546/2017, dt.26.03.2018, pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar me dt.25.04.2019, ne mungese te prokurorit e ne prezence te pandehurit ne te njëjtën date publikisht shpalli, e me datë 26.04.2019, merre këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari;**

**S.J**, nga i ati B. dhe e ëma S. e vajzërisë N., i lindur me ..., ne ... me venbanim ne ..., ne rrugën “...” nr. ..., me nr. personal ...,i martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, sipas profesionit punëtor, Serb, shtetas i Republikës se Kosovës.

**ESHTE FAJTOR**

**SEPSE:** Me date 01.03.2016 rreth orës 17:00 ne sallonin e parukerisë “...” ne ..., ne rrugën “...”, pas përleshjes verbale, ka ardhur deri tek personi fizik ashtu qe S.J e ka shtyrë Q.S, i cili është rrezuar ne toke dhe nga e rrezuara i ka thyer dy eshtra te nëngjurit te djathtë, ku i është shkaktuar thyerje e hapur.

Me këtë ka kryer veprën penale-**Lëndim i rend trupor nga neni 189 par 1. Nen par 1.3 te KPRK-ës** .

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 7,8,9,10,21,41,45,73, dhe 189 par 1 nen par 1.3 te KPRK-ës dhe nenin 365, 450, dhe 463 te KPP-ës.

**S H Q I P T O N**

Me dënim burgu ne kohëzgjatjeje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Pas shpalljes se aktgjykimit i pandehuri ka jap pëlqimin qe dënimi me burg te zëvendësohet me dënim me te holla.

**Gjykata duke u bazuar ne dispozitat e nenit 47 te Kodit te Republikës se Kosovës**

**Dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj ia ZAVENDESON ME DENIM ME GJOBE ashtu qe i akuzuari S.J obligohet qe te paguaj ne emër te gjobës**

**shumen prej 1000(njëmijë euro) i cili dënim duhet te përmbushet ne afat prej 15 ditove prej ditës se marrjes se formës se prere te aktgjykimit.**

OBLIGOHET i pandehuri qe ne emër te shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 Euro, ndërsa ne emër te ekspertizës mjeko-ligjore te paguaj shumen prej 20 Euro , dhe ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit shume prej 30 euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike -kompensimin e demit udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Mitrovice Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.1546/2017 te dt.26.03.2018, kundër te pandehurve: S.J nga Mitrovica me vendbanim ne ... rrugën "..." nr ... për shkak të veprës penale Lëndim i rend trupor nga neni 189 par.1 nen par .1.3 te KPRK-ës, dhe Q.S për shkak te veprës penale Lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.1 nen par. 1.3 te KPRK-ës.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt. 25.04.2019, ashtu qe ne këtë seance i pandehuri Q.S nuk e ka pranuar fajësinë dhe për ketë te pandehur gjykata ka vazhduar ne procedure te mëtejme për shqyrtimin e çështjes, ndërsa i pandehuri S.J, ne ketë seancë ka pranuar fajësinë për veprën penale qe ngarkohet sipas aktakuzës, dhe nen këto rrethana gjykata e ka veçuar procedurën penale ndaj këtij te pandehuri me aktvendim te datës 25.04.2019. i pandehuri S.J lidhur me fajësinë ka deklaruar: e ndjej veten fajtor me vjen keq për rastin qe ka ndodhur, rasti ka ndodhur aty për aty, dhe njëherit i premtoj gjykatës nuk do te përsërisë vepra penale dhe nuk do te kryej vepra te tilla penale.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurori deklaroi: e pranoj pranimin e fajësisë ndaj te pandehurit Srboljub Jevtiq, nga se pranimi i fajësisë është ne përputhje me nenin 248 ne KPRK dhe ne baze vullnetare pajtohem me pranimin dhe i propozoj gjykatës ne rast te vendimit mbi dënimin këtë pranim e merr si rrethanë lehtësuese,

### **Vlerësimi i pranimit te fajësisë.**

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare, pas sqarimeve te mjaftueshme nga ana e Gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimit te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuza, te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te

pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lendes si raporti penal nr. ... nga data 04.03.2016, raportet policore, deklaratat e të pandehurve –dëmtuarve „Fletë lëshimi nga Qendra Mjekësore ne ... nr. ..., raporti i dr. D.H-ekspert i mjekësisë familjare ne ... nga data 16.01.2018. andaj nga të gjitha këto prova dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit vërtetohet si është kryer vepra penale: Lëndim i rende trupor nga neni 189 par 1. Nën par. 1.3 të KPRK-se.

### **Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.**

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo vepër penale është e dënueshme prej gjashtë(6) muaj deri në një (5)vjet, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykate si rrethana rënduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat në të cilat ishte kryer vepra penale. Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale të kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e që nga deklarimi i tij me rastin e pranimit të fajësisë i njëjti deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tillë i të pandehurit për gjykatën shpreh një pendim të thellë të tij për veprën penale. Nga të gjitha këto gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurit pasi që për gjykatën në rrethana të tilla mjafton dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga se do të ndalojë kryerësin që të mos kryej vepra penale në të ardhmen e që ky është edhe qëllimi i dënimit. Nga të gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurit.

Gjykata ka aplikuar dispozitat e zëvendësimit të dënimit me burg me dënimin me gjobe, bazuar në nenin 47 të KPRK-ës, ku thuhet se kur gjykata shqipton dënim me burg deri në gjashtë muaj, gjykata njëkohësisht mundet të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobe, me pëlqimin e personit të dënuar. E në rastin konkret, pasi që i pandehuri ka kërkuar që dënimi me burg që gjykata ia ka shqiptuar të pandehurit t’ia zëvendësojë me dënim me gjobe, në këto rrethana gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke i’ua zëvendësuar në dënim me gjobe.

### **Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.**

i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro, ndërsa në emër të ekspertizës mjeko-ligjore të paguaj shumën prej 20 Euro, dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 euro, të gjitha këto është i obliguar që të paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **Lidhur me kërkesën pasurore juridike.**

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarit i ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450,463 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P. nr.501/2019 dt.26.04.2019**

Procesmbajtësja :  
**Hasnije Muhaxheri**

Gjyqtari :  
**Gëzim Ademi**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, nëpërmes kësaj gjykate